



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 57/16
Prishtinë, më 17.5.2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontić, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Petrit Gashi-Kryesues i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Avni Jashari – Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm në AKP, Adem Selishta nga AKP, Hilmi Jashari - Avokat i Popullit, Besim Morina –U.D Drejtor në IGJK, Suzana Pillana – nga IGJK, Raif Preteni - Drejtor i ZRRUK, Ramiz Krasniqi-udheheqës i financave në ZRRUK.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Norë Shabani – gazetare nga Koha Ditore, Arta Rexha - gazetare nga RROKUM TV, Rrahman Rama - monitorues nga BIRN, Kushtrim Ahmeti - gazetare nga KTV.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Instituti Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015;
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës Rregullore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015

Kryetari - Agjencia Kosovare të Privatizimit në pajtim me neni 20 të Ligjit nr. 04/L-034, i ka dërguar raportin vjetor Kuvendit të Kosovës. Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar për AKP-në për vitin 2015. Në raport janë pasqyruar në mënyre analitike por edhe në mënyrë të përmbledhur të gjitha shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike. Raporti po ashtu përmban të dhënat për të hyrat që ka realizuar AKP-ja.

Petrit Gashi - siç e dini ne jemi konstituar si bord në fund të vitit 2015 dhe më duket se në dy mbledhjet e para si formë urgjente i kemi aprovuar dy raportet e viteve të fundit të 2014 dhe 2015.

Avni Jashari – në bazë të ligjit Agjencia i dorëzon dy raporte vjetore e financiare: raportin vjetor të pasqyrave financiare për buxhetin e Agjencisë i cili financohet prej tarifës administrative dhe raportin vjetor të pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim. Gjatë viti 2015, agjencia ka shpenzuar 88% të buxhetit. Sipas kategorive buxhetore, me së paku ka pasur buxhet të shpenzuar në programin buxhetor të auditimit, për shkak se një numër të auditimeve janë paguar të realizohen në pjesën të parë të vitit 2016. Shpenzimet e shërbimeve janë realizuar 65% e buxhetit të planifikuar për shkak të kërkesës së planifikimit të shitjeve të cilat nuk kanë mundur të realizohen në shkallën e planifikuar si dhe shpenzimet tjera të ndryshme. Po ashtu niveli i shpenzimet kapitale është ndikuar nga vështërsit që i kemi lidhur me ndërtesën e AKP-së.

Kryetari – ju lutem të sqaroni për deputetë shpenzimet për paga dh mëditjet prej 98.93%, kur dihet fakti se bordi është emëruar në fundit të vitit 2015?

Avni Jashari - të gjitha aktivitetet e AKP-së përveç kompetencave ekskluzive të rezervuar sipas nenit 15, kanë vazhduar dhe për këtë arsye punëtorët kanë vazhduar të paguhet. Një prej sukseseve të jashtëzakonshme prej nëntorit të viti 2014 është trajtimi i aseteve të uzurpuara apo të shfrytëzuara pa bazë ligjore nga palët e treta, inkasimet e qerasë së pronave të ndërmarrjeve shoqërore si dhe shqyrtimi i kërkesave të kreditorëve. Gjatë vitit 2015 janë shqyrtuar 7800 kërkesa të kreditorëve, janë paguar 8 milion euro për 20% e punëtorëve, ndërsa kanë mbetur deri në fund të viti 2015 edhe 25 milion euro të tjera për t'iu shpërndarë punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, mirëpo këto kjo shumë pret vendimet e Odës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Lidhur me listat e ndërmarrjeve shoqërore që janë 185 gjatë vitit 2015 i kemi transferuar gjithsej 8 milion euro. Në fund të viti 2014 dhe në fillim të vitit 2015 kemi filluar veprime intensive kundër uzurpatorëve dhe janë liruar 116 prona në pesë rajonet në Kosovës, 194 raste të tjera i kanë nënshkruar kontratat e qerasë dhe janë paguar borxhet ato të cilat kanë mundur të inkasohen. Rritja e inkasimit të qerasë gjatë vitit 2015 për shkak të aktiviteteve të agjencisë ka qenë gjithsejtë 123% më e lartë se sa në periudhën e kaluar dhe inkasimi i qirasë është 3.2 milion euro. Sa i përket aktiviteteve të agjencisë deri në fund të vitit 2015 kanë qenë të shitura 1286 prona, ndërsa kanë mbetur 1699 prona të pa shitura, pra janë shitur vetëm 43% e pronave shoqërore dhe pjesa dërmuese e këtyre pronave janë me probleme katastrale, probleme të definimit ose në proceset e ndryshimeve të gjykatës.

Sa i përket fondeve në mirëbesim një prej tarifave kryesore të agjencisë pasi që është formuar bordi është transformimi i fondit tepricë në qeverinë e Kosovës dhe sipas vendimit të bordit qeverisë i janë transferuar 61.3 milion euro, si detyrim ligjor i agjencisë i këtyre fondeve pasi që të vendosen ndërmarrjet në likuidim. Në gjendjen e llogarisë bankare në fund të vitit 2015 kanë qenë 486 milion euro.

Kryetari – ju lutem të jepni sqarim për shumën e mjeteve në mirëbesim që mbahen nga AKP?

Avni Jashari –në dhjetor 2015 kanë qenë 486,819,224 euro e mjeteve në mirëbesim, ndërsa deri më 30 prill 2016, janë 478,407,762 euro.

Kryetari - edhe sa mjete të mirëbesimit pritet ti barten qeverisë pas procesit të likuidimit, ku sipas ligjit, mjetet që barten prej AKP-së në qeveri, mund të përdoren vetëm për investime kapitale që qeveria i propozon si projekte jashtë buxhetore dhe i aprovon Kuvendi.

Avni Jashari – theksoi se prej 61 ndërmarrjeve shoqërore në dy mbledhjet e bordit në muajin mars dhe prill të këtij viti, janë aprovuar shpenzimet për kreditorët dhe mbetja e fondeve të cilat do të shqyrtohen në të ardhmen prej bordit të drejtorëve është 13.3 milion euro që sipas dispozitave ligjore vendos për transferimin e tyre në buxhetin e Kosovës. Janë diku edhe 24 milion euro prej atyre fondeve që mbahen deri sa të vendoset për ankesat në dhomën e posaçme.

Besa Gaxherri – theksoi se kemi një agjension që ka shumë sfida dhe shumë probleme e çka është më e keqja që e ka një imazh shumë të keq dhe nga ju si kryesues dhe bordi kërkohet vërtetë punë dhe përkushtim. Sa i përket raportit 2015, ka mjaftë dilema dhe vërejtje. Po filloj prej shitjes së aseteve, ku i tërë procesi prej qershorit 2002 e deri në vitin 2015, janë gjithsej 1286 kontrata, dhe të ardhurat në shitje janë 66,223,469 euro. Në bazë të kësaj, numri i ndërmarrjeve në likuidim është 462, numri i ndërmarrjeve që nuk kanë asete e të vendosur në likuidim janë 18 dhe numri i ndërmarrjeve shoqërore që nuk kanë pas asnjë shitje janë 29.

E theksuat se ka ngecur puna dhe kjo shihet se në vitin 2015, ku likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore është zero. Gjatë periudhës raportuese agjencia nuk i ka publikuar listat e punëtorëve. Sa janë ndarjet nga shitja e aseteve, pse nuk ka pasur shpërndarje të mjeteve për punëtorët, a ka qenë pengesë mungesa e bordit apo për çfarë arsye? Sa i përket pronave të uzurpuara në raport janë paraqitur 270 asete të uzurpuara deri në vitin 2015. Për rastet sociale të këtyre pronave, shohim se janë paraqitur 13 raste dhe atë në Mitrovicë 6, në Gjilan 2, në Prizren 0, në Pejë 3, në Prishtinë 2, lidhur me këtë po me intereson a janë vërtet banues të cilët nuk kanë zgjidhje tjetër të banimit apo janë biznese e shënohen si raste sociale? Sipas rajoneve të objekteve fizike apo juridike që shfrytëzon asete është interesant me e shique tabelen, ku në Prishtinë, persona fizik janë 23, ndërsa juridik 49, në Pejë 26 persona fizik, ndërsa 8 juridik, Prizren 3 fizik ndërsa 24 juridik, Gjilani 3 persona fizik ndërsa 27 juridik, në Mitrovicë 7 persona fizik ndërsa 37 juridik, ajo që më intereson më shumë është Komuna e Mitrovicës a bëhet fjalë edhe për Mitrovicën e veriut? Ju përmendet 270 objekte të uzurpuara, më intereson se është e shprehur në miliona për objekt? Sa i përket Trepçës më intereson të dijë përveç punë së draftimin e ligjit a keni bërë ndonjë strategji të posaçme?

Sa i përket pagesës së mjeteve të shpronësimit, qeveria për asnjë ndërmarrje shoqërore nuk mund të mbyllë procesin e likuidimit, pa u paguar fondet e shpronësimit, prej të cilave pritet të paguhet 20% për punëtorët, pyetja është sa milion janë të papaguara në kuadër të këtij procesi? Lidhur me Fabrikën e Tubave në Ferizaj a janë paguar mjetet, ku ka mbetur çështje? A keni strategji për trajtimin e aseteve jashtë Kosovë? Ndër sfidat kryesore të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore janë diku 29,373 raste gjyqësore e kjo është katastrof, çfarë jeni duke vepruara në këtë drejtim, janë rreth 15,000 ankesa të kreditorëve në Dhomën e Posaçme.

Sa i përket shpenzimeve të Agjencisë, buxheti ka qenë i miratuar 10,211,383 euro, për paga dhe mëditje i keni shpenzuar 4,321,066 euro apo 98.93%. Siç e dimë bordi nuk ka qenë funksional për një kohë, një shpjegim për këtë? Ndërsa sa i përket nivelit të menaxhmentit të lartë, pozita të aprovuar me ligj janë 3, ndërsa pozita të plotësuar është vetëm 1, buxheti i aprovuar 107,702 ndërsa buxheti i shpenzuar 88,000 euro. Në bazë të kalkulimeve, i bie se menaxheri i lartë i ka marrë 7,413 euro rrogë mujore. Sa i përket menaxhmentit të mesëm, i keni pasur të aprovuara 15 pozita dhe të plotësuar po aq, buxheti ka qenë

550,000 euro ndërsa i shpenzuar 546,946 euro dhe rroga mesatare del 3,666 euro për menaxher. Niveli profesional i keni 212 të aprovuar dhe të plotësuar, buxheti ka qenë 3.5 milion euro dhe paga e këtij niveli është 1383 euro në muaj. Niveli mbështetës 28 i keni të aprovuar e 26 i keni të plotësuar, 181,000 euro i keni të shpenzime qe i bjen 582 euro pagë për një punëtor. Sa i përket shpenzimeve tjera, ajo që më ka bërë përshtypje janë shpenzimet e marketingut 4% dhe shpenzimet e përfaqësimit 16%, unë mendojë se ka pas nevojë me bë më shumë shpenzime të marketingut, ka nevojë shoqëria jone me ditë shumë gjëra çka bënë agjensioni i privatizimit dhe me procesin e privatizimit?

Avni Jashari – theksoi se prej janarit 2014 e deri më sot, agjencia nuk e ka të zgjedhur drejtorin menaxhues. Gjatë vitit 2015 kam funksionuar vetëm unë si menaxher pa dëshirën time e kam kryer një obligim ligjor që ma ka ngarkua bordi i drejtorëve. Sa i përket numrit të kontratave në vlerat e shitjeve te cilat ju referohet raporti vjetor nuk ka pasur shitje sepse është kompetencë ekskluzive e bordit, por në vitin 2015 kemi përgatitur planin e detalizuar te punës. Rastet sociale të cilat janë në shpalosur në faqen e internetit te AKP-së, prej 13 rasteve që janë shpalosur në fund të vitit 2015, tash janë vetëm 7 raste sociale. Prej 270 pronave të cilat janë të shfrytëzuara pa kontrata deri në fund të vitit 2015 prej tyre kanë qenë 167 raste uzurpime klasike. Kemi kërkuar asistencë edhe nga policia dhe në muajin prill është aprovuar rregullorja ku është përcaktuar se asetet me qera nuk do të vendosen ne tender pa u larguar uzurpatori nga ato prona. Prej 12 vjetëve të kaluar prej qiradhënieve të rregullta janë inkasuar 4.5 milion euro dhe mendoj që flet mjaft pa i llogaritur këto tri ndërmarrje kryesore të cilat aktivitete kryesore e kanë dhënien e qirasë, siç janë: Pallati i Rinisë, Tregu në Prishtinë dhe Hotel Grandi. Një pjesë e aseteve të uzurpuara janë në Mitrovicën Veriore që janë 27, në atë jugore janë vetëm 4 asete të uzurpuara. Kam pasur takim me prokurorin dhe kryeprokurorin në Mitrovicë dhe me drejtorin e policisë se veriut e ku kanë shprehur gatishmërinë që me na asistue. Në raport janë përmendur se 781 objekte janë me qira dhe nëse merret parasysh tregu edhe pallati i rinisë janë 826.

Besa Gaxheri - na njoftoni me sfidat më detajisht?

Avni Jashari - sa i përket sfidave, kanë qenë kompletimi i menaxhmentit që është e kompetencë ekskluzive e bordit të drejtorëve, pagesat për BSPK-në, aprovimi i pagesave prej 20% që bëhet me vendimin e bordit te drejtorëve, me qenë se nuk ka pas bord nuk ka pas lista të reja të cilat janë publikuar.

Besa Gaxherri – ju lutem të na sqaroni rreth pyetjes për nivelin e pagave të stafit menaxherial të AKP-së?

Avni Jashari –paga mesatare e punëtorëve të AKP së është 1.390 euro mesatarja. Sa i përket nivelit të pagave të menaxhmentit të lartë duhet me shikue arsyetimin pastaj e njoftojë komisionin. Niveli i pagave të stafit të AKP-së është aprovuar prej Bordit dhe është një nivel i kompensimeve me i ulët që ka Banka Qendrore dhe Trusti PENSIONAL. Sa i përket shpenzimeve të përfaqësimit, reprezentacionit në vitin 2015 i kemi ulur në minimum. Sa i përket pagave në muajin janar apo shkurt ka qenë njeri prej zyrtareve të suspenduare me gjysmë page dhe kjo është arsyeja qe figuron shuma 88,000 euro.

Petrit Gashi – është e vërtet se kemi punë shumë dhe ne e kemi nisur me një intensitet të lartë të punëve dhe po mundohem ti trajtojmë të gjitha çështjet. Njërin e kemi pas çështjen e Pallatit të Rinisë dhe dua të sqarojë se Pallati i Rinisë nuk do të shitet në asnjë pjesë. Problemet janë të mëdha kështu që ne tash kemi filluar me mendue se si do të menaxhojmë apo ti korrigjojmë defektet ku janë. Sa i përket çështjes së Trepçës është realitet që për herë të parë kemi filluar me u marrë si shoqëri me Trepçën. Ne i kemi pas një varg takimesh me gjitha instancat dhe i kemi shpërndarë detyrat, jemi të përfshirë në draftimin e ligjit të ri që është duke hartuar qeveria, dhe ne si AKP në kuadër të këtij procesi kemi bërë incimin e një studimit të fizibilitetit, në koordinim me kryetarin e komisionit për zhvillim ekonomik

kemi hartuar termat e referencës dhe tani jemi në fazën e tenderimit që merr kohë. Por, realisht ne jemi shumë vonë lidhur me Trepçën, pasi që është dashur të kryhej studimi i fizibilitetit që do ti paraprinte legjislacionit dhe ndryshimeve tjera. Sido që të jetë me ligj për Trepçën ajo do të shëndrrohet fillimisht në ndërmarrje publike që do të jetë një zgjidhje e përkohshme sepse Trepça nuk mund të funksionojë si ndërmarrje publike. Në bazë të analizave tona që nuk janë përfundimtare, vlera e kërkesave kreditore që mund të pranohen janë jashtëzakonisht më të ulëta se që kreditohet prej kreditorëve. Çështjen e shpronësimeve dhe të lëndëve që e kemi ne gjykata apo ato që e kemi në dhomën e posaçme unë konsiderojë si dy sfida që një është çështja e lendeve në dhomën e posaçme, që i trajtojë si lëndë që lidhen me procesin e privatizimit dhe tjetra është çështja e shpronësimeve. Nëse nuk përshpejtohet procesi i punës në trajtimin e këtyre lëndëve, atëherë do të merr shumë kohë procesi i privatizimit. Për Fabrikën e tubave ju themë të drejtën është shumë komplekse dhe hapat që i kemi ndërmarrë deri me tash skemi mundur me asgjë tjetër vetëm interpretime dhe kemi dy apo tri interpretime ligjore. Për këtë çështje kemi biseduar me kryeparlamentarin dhe kryeministrin dhe jemi zotuar se diku në qershor do të trajtojmë dhe do të marrim një vendim.

Adem Grabovci - sa i përket fabrikës së tubave, ne kemi një vendim të Gjykatës për kompensimin e punëtorëve që është vendim i formës se prerë dhe është obligativ dhe duhet të respektohet dhe ekzekutohet. Prandaj po më intereson se në çfarë faze është dhe për formën e kompensimit të këtij aktgjykimi?

Petrit Gashi – ne të gjitha vendimet që janë marr prej Gjykatës Kushtetuese, Qeverisë dhe Rezolutën e Kuvendit të Kosovës i kemi analizuar, por t'iu themë të drejtën ne kemi menduar edhe për kanalet e mundshme të pagesës. Por thënë realisht kur ballafaqohen juristët e AKP-së dhe ata të Fabrikës ka interpretime të ndryshme. Jemi zotuar se do ti shohim të gjitha mundësitë për të gjetur zgjidhen.

Pas diskutimeve dhe propozimit, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015

Kryetari – theksoi se në pajtim me Ligjin për avokatin e popullit, institucioni i avokatit të popullit ka raportuar në Kuvend. Raporti përmban të dhëna për buxhetin dhe shpenzimet për kategoritë dhe nënkategoritë ekonomike. Si dhe krahasimet me periudhën paraprake.

Hilmi Jashari - theksoi se pengesat kryesore ka qenë çështja e objektit dhe në planifikimin e vitit 2015 është menduar me i punësue 10 veta dhe për shkak të hapësirës së kufizuar ka qenë e pamundur me i punësu këta njerëz. Në ndërkohë është bërë zgjidhja e objektit që ka qenë edhe proces i ndërlidhur me liberalizimin e vizave.

Kryetari - ne mendoj se me rishikim do të bëjmë plotësimin e mjeteve te avokatit te popullit që të ketë pavarësinë më të madhe buxhetore.

Besa Gaxherri - buxheti vjetor me ligjin e buxhetit në vitin 2015, ka qenë 1,913,322 euro, me rishikim ka pasur ndryshim në 951,000 euro dhe buxheti përfundimtar ka qenë 933,104. Shpenzimet deri me 31 dhjetor janë 832,000 euro, që do me thanë nuk janë bërë shpenzimet edhe sa janë rishikuar, ku është problemi për mos shpenzim të mjeteve?

Kryetari - këta nuk kanë marrë punëtor të tjerë sepse nuk kanë pas buxhet.

Pas diskutimeve dhe propozimit, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Instituti Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015

Kryetari - në bazë të nenit 6.1 të Ligjit të themelimit të institutit të Kosovës, instituti financohet nga buxheti i Kosovës edhe si rrjedhojë i paraqet Kuvendit i raporton për shpenzimet e buxhetit. Raporti vjetor financiar i institutit për 2015 pasqyron të dhëna për buxhetin e miratuare, që ka qenë një ndarje prej 626,280 euro, me rishikim ishte 556.994 euro.

Besim Morina - buxheti i institutit për vitin 2015 ka pasur disa shkurtime nga 52,000 euro me rishikim dhe si buxhet i mbetur ishte 512,450 euro, ndërsa është realizuar në masën prej 95%. Buxheti është shfrytëzuar në organizimin e aktivitete trajnuese, po ashtu përveç kësaj një shumë e madhe e buxhetit shfrytëzohet shkon për pagat. Përveç pagave për stafin e këtij instituti, anëtarët e Këshillit Drejtues paguhen në bazë të takimeve. Tek kategoria mallra e shërbime është shpenzuar buxheti 93%, që është kategoria që instituti ka më së shumti mjete financiare dhe këtu hyjnë të gjitha shpenzimet që realizohen për trajnime, qiraja që nuk është një shumë vogël. Sa i përket shpenzimet komunale buxheti ka qenë i pamjaftueshëm dhe si rezultat kemi bërë një transfer nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa lidhur me donacionet kemi pas diku shumë prej 18,000 euro që ka qenë projekti me UNICEF, ndërsa pjesa tjetër e donacioneve ose aktivitete që realizohen nga donatorët të ndryshëm ne i marrim si shërbime, por në raste edhe pajisje që ofrohen e sipas informatave prej këtyre donatorëve për vitin 2015 është një shumë prej 373,000,23 euro.

Kryetari - çka është për mua për me e ditë objekti ku jeni me qira paguani dikun me 75,000 euro brenda vitit, a keni biseduar me Ministrinë e Administratës Publike, dhe a keni kërkuar hapësira ku mund të vendosni në një objekt shtetëror?

Besim Morina – theksoi se ne kemi qenë në bisedime të vazhdueshme me Ministrinë e administratës publike, kemi pas edhe disa shkresa zyrtare për komunën e Prishtinës dhe deri më tani nuk kemi arrit me siguri një vend apo një ndërtesë shtetërore ku mund ti zhvillojmë aktivitetet.

Pas diskutimeve dhe propozimit, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës Rregullore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015

Safete Hadergjonaj- në bazë të Ligjit për Rregullimin e Shërbimit të Ujit, neni 10, Zyra e rregullatorit ujësjellës edhe kanalizim duhet të raportoj Kuvendit për aktivitetet vjetore, përfshirë edhe për shpenzimet e buxhetit.

Raif Preteni – theksoi se që nga data 16 prill 2015 deri me 28 prill 2016, Autoriteti për Shërbimet e Ujit ka mbetur pa drejtor dhe si pasojë autoriteti është përcjellur me vështësi të mëdha që të gjitha kompanitë rajonale të ujit janë pa licenca të shërbimit. Ligji i ri për shërbimin e ujit nuk ka mund të zbatohet por kjo ka ndikuar në shkallën më të ulët të inkasimit të taksës vjetore të licencimit si dhe në zbatimin e planit operativ. Buxheti për vitin 2015 është aprovuar prej 383,632 euro, për paga e mëditje janë 242,412 euro, mallra e shërbime 133,000 euro, komunal 6,503 euro. Kemi pasur një shkurtrim buxhetor prej 70,000 euro dhe buxheti final për vitin 2015 ka qenë 312,000 euro. Realizimi i buxhetit është 93.73%. Sa i përket të hyrave të licencimit, ARRU ka realizuar të hyra prej 336,985 euro apo në përqindje 87,84%.

Besa Gaxheri - sa i përket shpenzimet për mallra dhe shërbime, në nënkategorinë udhëtimet jashtë vendit shpenzimet janë zero, ndërsa për mëditje jashtë vendit shpenzimet janë 3,836 euro që 95% e planifikimit, kërkohet një sqarim? Shpenzime për informim publik i keni realizuar vetëm 58% dhe ne e dimë se ka nevojë me u informu publiku për shumë çështje sa i përket ujësjellësit e kanalizimit dhe është dashur të informohen më shumë qytetarët me punën tuaj. Komuna e Novobërdës, Zubin Potokut, Leposaviqi, Kaçanikut dhe Zveçanit janë jashtë shërbimeve të zyrës suaj, pse ndodh kështu? Në tabelë faqe 17 që janë të dhëna për shërbimet e sektorit të ujit dhe kur të krahasojmë vitin 2014 me 2015, fatkeqësisht në vitin 2014 është prodhuar më pak, kurse në 2015 kalon 137,000 litra, por kur dalim në ujin e humbur kemi më shumë ujë të humbur në vitin 2015 për dallim se sa i keni planifikuar. Pra në bazë të planifikimit ju jeni mbrapa dhe me inkasim dhe me ujë të humbur. Sa është përqindje e popullatës pa ujësjellës dhe pa kanalizim? Sa i përket faljes së borxheve, më duket se nuk është puna mirë me këto shërbime? Po ashtu e dimë pagesat për ujësjellës dhe kanalizim bëhen paushall sidomos nëpër zona rurale, por ka raste kur qytetarët në pjesë të qytetit edhe pse nuk kanë ujë mjaftueshëm e paguajnë ujin paushall. A keni bërë diçka në këtë drejtim?

Raif Preteni – sa i përket komunave që janë jashtë sistemit të zonës së shërbimeve që janë komunat në veri të Mitrovicës ne kemi shqiptuar gjobë prej 50,000 euro dhe nuk kanë kthyer kurrfarë përgjigje dhe lëndën e kemi dërguar në gjykatë. Kaçaniku nuk është jashtë sistemi por është me Ferizajn, dhe mund të ketë ndodhur ndonjë gabim në raport. Uji i humbur vërtetë është shqetësuese sepse uji i humbur mesatarisht është 56%. Por këtu përgjegjësia është edhe tek kompanitë e ujësjellësit dhe bordet, respektivisht tek stafi ekzekutiv ndaj të cilëve ka kompetenca ka bordi që zgjidhet nga qeveria. Sa i përket bazës ligjore, në janar ka hyrë në fuqi ligji i ri, për çfarë edhe ka ndërruar emri i institucionit tonë në Autoritet të Shërbimeve të Ujit, për çfarë do ta bëjmë sot ndryshimin formal. Falja e borxheve bëhet sipas ligjit dhe kompanitë janë të obliguar me zbatue ligjin.

Pas diskutimeve dhe propozimit, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Zyrës Rregullore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuësve dhe punëdhënësve dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetari – projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuësve dhe punëdhënësve dhe amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetari – projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Të ndryshme

Kryetari - siç jeni në dijeni për procedimin me procedurë të përshpejtuar të Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit, në kuadër të kësaj ne kemi pranuar disa vërtetje dhe sugjerime nga Zyrës e BE-së, EULEX-i, Shoqata e Bankave të Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile. Prandaj me qëllim të trajtimit të këtyre vërejtje, propozojë që të autorizohemi unë dhe Safete Hadërgjonaj, dhe pastaj të paraqesim propozimet konkrete në komisionin me rastin e shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjit.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni krijon grupin punues për shqyrtimin e Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit, i përbërë prej: Naser Osmani (kryesues) dhe Safete Hadërgjonaj.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani